Kronikë

FOTO/ Bulqizë, gjenden 1416 kg lëndë plasëse dhe 220 kapsolla elektrike! Dhjetra kuti e shishe qumështi plot me lëndë plasëse

Policia në Bulqizë ka goditur një rast i paligjshëm i tregtimit të lëndëve plasëse.

Foto: Eksplozivi i sekuestruar

Redaksia
8 Shkurt, 12:11 | Përditësimi: 8 Shkurt, 12:33

Share

Policia në Bulqizë ka goditur një rast i paligjshëm i tregtimit të lëndëve plasëse.

Janë sekuestruar 1416 kg lëndë plasëse dhe 220 kapsolla elektrike ndërsa ka nisur procedimi penal për Genci Çukën.

> *Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Bulqizë, në përmbushje të objektivave të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e informalitetit, në bashkëpunim me Prokurorinë, bazuar në inteligjencën policore se një subjekt në mënyrë të paligjshme tregtonte (shiste), lëndë plasëse në disa subjekte të tjera minerare, kanë organizuar punën me qëllim verifikimin, parandalimin e mbetjeshëm dhe goditjen e kësaj paligjshmërie.*

[Sh].com

LEXO EDHË:
Burrel/ Metalurgët në protestë: Duam rritje pagash, përshkallëzim nëse s'na plotësohet kërkesa (VIDEO)

Si rezultat, u referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal, për veprën penale "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive" për shtetasin G.Ç., 55 vjeç, banues në Tiranë.

Ky shtetas, në Thekën Martanesh, pasi magazinonte në depon e tij, sasi me lëndë plasëse me qëllim për përdorim vetiak, më pas në mënyrë të paligjshme dhe pa autorizim përkatës nga Komisariati i Policisë, e tregtonte (shiste) lëndën plasëse në 9 subjekte të tjera, duke u mjafturar vetëm me një akt-marrveshje të lidhura mes palëve (subjekteve).

Në këtë subjekt janë sekuestruar 1416 kg lëndë plasëse dhe 220 kapsolla elektrike.

Kontrollet në subjektet minerare të qarkut, me qëllim verifikimin e zbatimit të ligjeve, kritereve dhe standardeve të sigurisë, vijojnë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

Lajmi ne perditesim...

S.G/Shqiptarja.com

TAG: Dibër Bulqizë

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
3 vjet burg për lidhjen e 2 a më shumë martesave njëkohësisht, si ju duket?

E drejtë E gabuar Nuk e di

Lajme të tjera

Bulqizë/ Vdiq në punë, familjarët kërkojnë drejtësi për elektricistin 32-vjeçar: Të hetohet OSHHE për shkelje të rregullave
7 Shkurt, 18:49

Dibër, burri tenton të vrasë me sëpatë gruan me mikun e saj, po shkote në gjykatë për divorc
6 Shkurt, 14:10

Me thikë me vete gati për sherr, vihet nën hetim 15-vjeçari në Dibër
3 Shkurt, 13:02

Shkaktoi aksident me vdekje, arrestohet 54-vjeçari në Dibër! Në policia tha se 'ishte pasagjer e makinën e drejtonte viktima'
1 Shkurt, 12:19

Dibër/ 25-vjeçari vetëplagoset me armë gjahu në këmbë, përfundon në spital
31 Janar, 15:31

E rëndë në Bulqizë, elektricisti 32 vjeç bie nga shtylla dhe humb jetën
31 Janar, 14:20

Tre organizata kërkuan anulimin e hidrocentralit të Skavicës, Gjykata Kushtetuese: Në këtë fazë s'ka projekt për shqyrtim, u cenua e drejta për informim
30 Janar, 16:30

Zv.ambasadorja britanike, Marzouk në Dibër: E befasuar nga energjia e të rinjve
29 Janar, 22:25

Ndihmuan çiftin zviceran që u bllokua në Korab, Bashkia Dibër ndan certifikata mirënjohje për 2 policët e kufirit dhe grupin e kërkim shpëtimit të Kosovës
27 Janar, 16:45

Njihuni me 'tarzanin e Dibrës,' zhytet në ujë me akull e temperatura – 12 gradë! Shulku: Majën e Korabit e kam ngjitur mbi 20 herë

Mahir Jangulli

29 Janar, 14:50

Përplasen dy makina në aksin Burrel-Klos, plagosen 2 pasagjerë
25 Janar, 16:53

VIDEO/Kreu manovra të rrezikshme me makinë, ndëshkohet me gjobë shoferi në Burrel
23 Janar, 15:53

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaktësuar i kesaj faqeje